




Projekt i bashkëfinancuar nga Fondi i Zhvillimit Rajonal Evropian

Projektit i mbetjeve nga plastika ne ZMD është një projekt i financuar nga Interreg Med që synon ruajtjen e biodiversitetit dhe ruajtjen e ekosistemeve natyrore në zonat bregdetare dhe ato mbrojtura detare duke konsoliduar përpjekjet e Mesdheut kundër mbetjeve detare.

Projekti përfshin veprime që adresojnë të gjithë ciklin e menaxhimit të mbetjeve detare, nga monitorimi dhe vlerësimi, deri te parandalimi dhe zbutja.

Projekti përdor strategjinë multidisiplinare dhe kuadrin e përbashkët të veprimit të zhvilluar brenda iniciativës së Ndotjes nga Plastika, të udhëhequr nga Universiteti i Sienës dhe Rjeti i Zgjidhjeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kjo iniciativë kornizon veprimet prioritare të nevojshme për trajtimin e mbetjeve detare në Mesdhe dhe u emërua nga Bashkimi për Mesdheun në 2016, duke mbledhur mbështetjen politike të 43 vendeve të Euro-Mesdheut.

Projekt i etiketuar nga UFM - Unioni për Mesdheun



PARTNERËT E PROJ



PARTNERË TË ASOCIUAR



plasticbustersmpas.interreg-med.eu



@PlasticBustersMPAs



@PlasticB_MPAs

Contact:
teresa.romeo@isprambiente.it
fossi@unisi.it



5.055M €
buxheti i
projektit

4.296M €
ERDF/IPA

48 months
kohëzgjatja
e projektit

MBETJET PLASTIKE NE ZONAT E MBROJTURA DETARE RUAJTJA E BIODIVERSITETIT NGA PLASTIKA NË ZONAT E MBROJTURA DETARE TË MESDHEUT



ÇËSHËTJA NË DISKUTIM

Mesdheu është një nga detet më të prekura nga mbetjet detare në mbarë botën. Kërcënimet që mbeturinat detare paraqesin në jetë e eger dhe ekosistemet janë gjithnjë e më të dokumentuara në literaturën shkencore, me ndikime që ndryshojnë nga kapja/lidhja dhe gjëllitja, deri te bioakumulimi dhe bio-zmadhimi i toksinave të lëshuar nga plastika, si dhe dëmtimi i habitateve dhe specieve të fundit të detit.

Plani rajonal i Konventës së Barcelonës për menaxhimin e mbetjeve detare në Mesdhe dhe Direktiva Kuader e Strategjisë Detare të Komunitetit Evropian, kanë ndihmuar që gjërat të përparojnë në drejtimin e duhur. Megjithatë, ka ende një rrugë të gjatë për të bërë në drejtim të zbatimit të angazhimeve të politikave dhe reduktimit në mënyrë efektive të mbetjeve detare dhe rreziqeve që ato paraqesin në botën e eger detare të Mesdheut.



KUSH JEMI NE

Projekti Mbetjet Plastike ne Zonat e Mbrojtura Detare ka bashkuar 15 partnerë zbatues dhe 17 partnerë të asociuar nga 8 vende, përkatësisht Shqipëria, Qipro, Kroacia, Franca, Italia, Greqia, Sllovenia dhe Spanja. **Njihuni me ekipin tonë dhe partnerët e asociuar:** plasticbustersmpas.interreg-med.eu/our-story/who-we-are/



- Partnerët institucionalë
- Partnerët operacionalë
- ◆ ZMD testuese
- ★ ZMD transferuese
- LP: Partner udhëheqës (ISPRA)
- SC: Koordinator Shkencor (UNISI)

PROJEKTI MBETJET PLASTIKE NE ZONAT E MBROJTURA DETARE TRAJTON TË GJITHË CIKLIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE DETARE

MONITORIMI I HARMONIZ


Përcaktimi dhe testimi i metodologjive të monitorimit të harmonizuar të mbetjeve detare në zonat detare detare dhe bregdetare

PËRCAKTIMI I PLANIT TË PËRBASHKËT TË QEVERISJES

Sigurimi i marrjes së rezultateve të projektit nëpërmjet një plani të përbashkët qeverisës i cili do të fuqizojë menaxherët, vendimmarrësit dhe aktorët e tjerë të ZMD-ve-it për të ndërmarrë veprime të koordinuara dhe të synuara kundër mbeturinave detare

NDËRTIMI I KAPACITETEVE DHE TRANSFERIMI I NJOHURIVE

Zbatimi i transferimit të njohurive të përshtatshme kundrejt qëllimit dhe krijimi i mekanizmave të kapitalizimit dhe replikimit për epime efektive dhe të vazhdueshme ndaj mbetjeve detare



MASAT PARANDALUESE E ZBUTESE

Zhvillimi i udhëzësve rajonale për të mbështetur veprimet e përsëritura bazuar në mësimet e nxjerra nga 10 demonstrime që tregojnë masat që duhen marre ndaj mbetjeve detare

ÇFARË BËJMË NE

Projekti Mbetjet Plastike ne Zonat e Mbrojtura Detare ofron një qasje gjithëpërfshirëse, të shumëfishtë dhe të koordinuar për të luftuar mbetjet detare në zonën pelagjike, dhe ato të mbrojtura detare të Mesdheut me qëllim krijimin e ekosistemeve të shëndetshme detare.



AJO QË NE SYNOJMË TË ARRIJMË

Qëllimi përfundimtar i projektit të mbetjeve nga plastika ne ZMD është të rritë mbrojtjen e habitateve dhe specieve në zonat detare dhe ato të mbrojtura detare dhe pelagjike përmes monitorimit dhe vlerësimit të synuar, veprimeve parandaluese dhe lehtësuese. Kjo arrihet përmes përsheptimit të transferimit të njohurive, rrjetëzimit midis dhe ndërmjet ZMD-ve dhe krijimit të sinergjive me proceset e qeverisjes evropiane dhe mesdhetare.